



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 170, Datë 03.08.2018

MBI

**MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TË MIREKUPTIMIT MBI BASHKËPUNIMIN
E TREGJEVE DITORE TË ENERGJISË ELEKTRIKE MES PALËVE, ENTI
RREGULLATOR I ENERGJISË SË SHQIPËRISË (ERE), ZYRA E
RREGULLATORIT TË ENERGJISË TË KOSOVËS (ZRrE), OST SH.A, KOSTT
SH.A.**

Në mbështetje të nenit 7, pika 2; neneve 16 dhe 18; nenit 19, gërma e; nenit 56, gërma i, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike“ i ndryshuar, nenit 15 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016; si dhe në kuadër të Memorandimit të Bashkëpunimit të 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor, mbi Zhvillimin e Tregut Rajonal të Energjisë dhe Vendosijen e një Kuadri Ligjor për Bashkëpunim të Mëtejshëm (Memorandum of Understanding (MoU) of Western Balkan 6 on Regional Electricity Market Development and Establishing a Framework for other future collaboration), nënshkruar në Vienë në 27.04.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 03.08.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike, mbi miratimin e Memorandimit të Mirëkuptimit mbi bashkëpunimin e tregjeve ditore të energjisë elektrike mes palëve, Enti Rregullator i Energjisë së Shqipërisë (ERE), Zyra e Rregullatorit të Energjisë të Kosovës (ZRrE), OST sh.a, KOSTT sh.a.

Konstatoi se:

- Në kuadër të projektit për bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike Shqipëri – Kosovë nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë dhe konsulenca për këtë projekt është draftuar Memorandumi bashkëlidhur, i cili ka si qëllim të lehtësojë harmonizimin e tregjeve të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës, përsa i përket lehtësimit të procedurave të bashkëveprimit të këtyre tregjeve.
- Palët zotohen të implementojnë projektin nga Programi i iniciativës së 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor (Western Balkan 6; WB6) për integrimin e tregut ditor të energjisë elektrike për të cilin bashkërisht janë përgjegjëse. Objektivi i projektit është implementimi i tregut ditor të energjisë elektrike në Shqipëri dhe Kosovë në mënyrë efikase
- Për këtë qëllim, autoritetet rregullatore, ZRrE dhe ERE, zotohen që të vazhdojnë bashkërisht punën për lehtësimin dhe koordinimit të mbikëqyrjes rregullatore,

zhvillimin e deklaratave të përbashkëta, dhe udhëheqjen në marrjen e vendimeve të përbashkëta për implementimin e kësaj iniciative.

• **Detyrat e përgjegjësitë e ERE janë :**

- Angazhimi në zhvillimin dhe funksionimin e një tregu rajonal konkurrues në Komunitetin e Energjisë.
- Eliminimi i kufizimeve në tregtimin e energjisë elektrike me vendet anëtare të Komunitetit të Energjisë, duke përfshirë zhvillimin e kapaciteteve ndërkufitare të transmetimit.
- Bashkëpunimi me autoritetet rregullatore të vendeve të tjera fqinje, si dhe me Bordin Rregullator të Komunitetit të Energjisë për harmonizimin e kuadrit rregullator për zhvillimin e tregut rajonal të energjisë elektrike, përfshirë edhe shkëmbimet ndërkufitare të energjisë elektrike dhe rregullat për menaxhimin e kapaciteteve të interkoneksionit,
- ERE duhet të garantojë që, Tregtarët dhe furnizuesit e energjisë elektrike, të regjistruar në një shtet tjetër anëtar të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, kanë të drejtë të marrin pjesë në tregun e energjisë elektrike, bazuar në parimet e reciprocitetit dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të miratojë dhe nënshkruajë Memorandumin e Mirëkuptimit mbi Bashkëpunimin e Tregjeve Ditore të Energjisë Elektrike mes palëve, Enti Rregullator i Energjisë (ERE), Zyra e Rregullatorit të Energjisë të Kosovës (ZRRë), OST sh.a., KOSTT sh.a.
2. Për Entin Rregullator i Energjisë (ERE), Memorandumi do të nënshkruhet nga Kryetari.
3. Drejtorja e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë Palët për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.